

Sinjalizime

Ekskluzive | Punëtorët e KRU-së nën breshëri plumbash në Vushtrri – ky është personi që dyshohet se hapi zjarr ndaj tyre



Sinjali.com

30 Korrik 2026 08:18



Një incident i rëndë ka ndodhur paraditen e së mërkurës në fshatin Pantinë të Vushtrrisë, ku një person dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të punëtorëve të KRU “Mitrovica”, pasi ata kishin shkuar t’ia ndërprisnin furnizimin me ujë.

Sinjali mëson ekskluzivisht se personi që kërkohet nga Policia është Fitim Shabani rreth 41 vjeç.

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur rreth orës 11:50, në rrugën “Islam Shabani”, kur ekipi i KRU-së po kryente ndërprerjen e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit.

Tre punëtorët – S.H rreth 50-vjeç, F. B. rreth 35-vjeç dhe F. Sh. rreth 61-vjeç – kanë deklaruar se i dyshuari fillimisht u kishte drejtuar një armë të shkurtër dhe kishte kërkuar që t’ia rikthenin furnizimin me ujë. Pasi ata kishin refuzuar, ai dyshohet se ka shtënë me armë në drejtim të automjetit, derisa punëtorët ndodheshin brenda tij.

Sipas dëshmive, pas të shtënës, i dyshuari kishte marrë gëzhojën, ishte futur në oborrin e shtëpisë dhe më pas kishte dalë sërish, duke i kërcënuar punëtorët me fjalët:

“Nëse më lajmëroni në Polici, ka me ju vra të treve.”

Menjëherë pas raportimit, në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë policore, përfshirë edhe Njësinë për Reagim të Shpejtë, të cilat kanë krijuar një perimetër sigurie dhe, me urdhër të Prokurorit të Shtetit, kanë kryer bastisje në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të dyshuarit.

Gjatë kontrollit nuk është gjetur arma që dyshohet se është përdorur.

Me urdhër të Prokurorit është iniciuar rasti për veprat penale “Kanosje”, “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armës”, ndërsa Fitim Shabani ndodhet në arrati dhe është në kërkim nga Policia e Kosovës.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Armë

KRU

Punëtorët

Vushtrri

Të tjera:



Ekskluzive | FOTOJA e tradhtoi 25-vjeçarin në Prizren – pranoi se posedonte armë,...

Sinjalizime



Ekskluzive | Të shtëna me armë në restorantin “Iliria De Luxe” në Podujevë – 24-vjeçari...

Sinjalizime



Ekskluzive | Arrestohet 49-vjeçari në Gjakovë – Policia i gjen pistoletë “SIG Sauer” dhe fishek...

Sinjalizime



Ekskluzive | Babai ia dha armën djalit 16-vjeçar për të shtënë në aheng – Policia bastis shtëpinë...

Sinjalizime



Trump: Do të zhgënjehesha shumë me Xi Jinping nëse Kina i shet armë Iranit

Botë



Ekskluzive | Këta janë vëllezërit që u ndaluan pas plagosjes me armë në Prishtinë – i plagos...

Sinjalizime



Policia qëllon për vdekje furgonin dhe të dyshuarin për sulmin me thikë në Berlin Pride

Evropë



Ekskluzive | Sherri për pronën përfundon me plumba në Vushtrri – i dyshuari vetëdorëzoh...

Sinjalizime

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtesë
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera